

**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"MELA" SH.P.K.**



Ky statut perpilohet nga :

1.1 quajtur me poshte ortakut i vetem themelues ,me vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.7632,date 04.11.1992"Per dispozitat qe regullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar ",me ligjin Nr.7638,date 19.11.1992"Per shoqerite Tregtare",si dhe me aktet e tjera te legjislacionit shqiptar qe trajtojne keto ceshtje,krijon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ,si vijon :

**KREU I**

**FORMA,EMERTIMI,OBJEKTI,SELIA,KOHEZGJATJA**

**NENI 1**

**FORMA**

Ortakut i vetem themelues ka krijuar nje Shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Shqiperi dhe me dispozitat e ketij Statuti.

**NENI 2**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

Emertimi i Shoqerise do te jete " **MELA** "sh.p.k.

**NENI 3**

**SELIA E SHOQERISE**

Selia qendrore e shoqerise do te jete ne Tirane,Bulevardi "Zogu i Pare" .Shoqeria ka te drejte qe me vendim te asamblese se ortakëve (ortakut te vetem) mund te hape dege zyra,filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.

**NENI 4**

**KOHEZGJATJA**

Shoqeria do te kete kohezgjatje mbi 10 vjet.Si date fillestare meret data e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Tiranës.

**NENI 5**

**OBJEKTI I SHOQERISE**

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si vijon :

**1.Prodhim material ndertimi**

Prodhim materiale inerte-guri.

Prodhim elemente betoni e beton arme te zakonshem,paranderur ,gure

Dekorative etj. .

Prodhim materiale lidhes gelqere-allci-cimento.

**2.Ndertime Civile dhe ekonomike**

a) Ndertime civile,industriale,turistike,bujqesore deri ne 5 kate dhe komplrtimi me instalimet e nevojeshme per to .

b) Ndertime civile ,industriale ,turistike bujqesore mbi 5 kate ,rikonstruksione dhe kompletimi me instalimet e nevojeshme .

**4.Ndertime Rrugore dhe aeroporte .**

a) Ndertim rruge kategoria V dhe IV

b) Ndertim rruge kategoria III dhe II – I dhe rruge speciale (autostrada etj).

c) Veshje me asfaltobeton te rrugeve (ndertim mbishhtrese )si dhe sistemim e asfaltim sheshe .

d) Ndertim pista e aeroporte.

dh-Punime te mirmbajtjes ,sinjalizimit dhe vijezimit ne rruge, ndertim dhe shtresa rrugore.

## 5. Ndertime Hekurudhore

- a) Ndertim hekurudha
- b) Punime speciale te shinave dhe binarve .
- c) Punime ne sistemin elektrik dhe te sinjalizimit.

## 6. Ndertim Ura dhe vepra arti

- a) Ndertim vepra arti rrugore dhe hekurudhore.
- b) Ndertim ura dhe vepra arti mbi 10 m.
- c) Ndertim tunele rrugore – hekurudhore

## 7. Ndertime detare

- a) Ndertime portuale , basene etj.
- b) Punime thellimi ne porte .

## 8. Ndertime Hidraulike e Hidroteknike

- a) Ndertim ujesjelles,kanalizime,kanale e impiante vaditjeje.
- b) Punime mbrojtje te sistemit hidraulik-cimentime e tjere.
- c) Ndertim impiante te trajtimit te ujit.
- d) Ndertim vajsjelles ,gazsjelles,naftesjelles.
- e) Ndertim diga-damba deri 10 m.

## 9. VEPRA TE VEÇANTA E PUNIME SPECIALE

- a) Sillose ,kulla,kulla uji etj. b/a metalike
- b) Perforcime themeli e punime nentokesore.
- c) Izolime mbi dhe nentokesore nga ujrat.
- d) Themele te vecanta
- e) Puse shpimi ,gjeologo inxhinierike,çpime per uje.

## 10. PUNIME RESTAURIMI

- a) Restaurimi i ndertesave monument kulture.
- b) Punime restaurimi ne vepra arkeologjike.

## 11. PUNIME KARPENTERIE

- a) Druri
- b) Metali

## 12. IMPIANTE TEKNOLOGJIKE DHE TE VECANTA

- a) Instalimi i impianteve ngritese dhe transportuese (ashensore,shkalle levizese,transportues ne pergjithesi ) mirmbajtja e tyre
- b) Instalimi i impjanteve termik-ventilimit-kondicionimit te ajrit-mirmbajtja e tyre.
- c) Instalimi i impjanteve higjenike,kuzhina,lavanteri,hidrosanitare ,mirmbajtja e tyre.
- d) Instalimi i materialeve prej druri – metalike – plastike xhami etj.
- e) Punime bojatisje – hidroizolimi,termoizolimi – akustike kundra zjarrit.
- f) Instalimet e impianteve nenpresion,mirmbajtja e tyre.

## 13. PUNIME MONTIMI ,NE IMPIANTET E PRODHIMIT

### DHE SHPERNDARJES SE ENERGJISE

- a) Centrale hidraulike
- b) Centrale termike – prova me ngarkese
- c) Impiante per prodhimin e energjise nga burime alternative .
- d) Instalime per n/stacionet – kabinat e transformatoreve ,linjat e TN e te mesem.
- e) Instalimi i linjave dhe kabinave elektrike te T.U linjave per telefoni,radiotelefonitelevizive ,citofoni,mirmbajtja e tyre.

## 14. PUNIME SHERBIMI

- a) Punime me sip.te gjelberta parqe pyll parqe.
- b) Pastrimi i sip.urbane.
- c) Mirmbajtja dhe zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane ,ndricimi dhe sinjalizimi Urban.

## **15 Ne fusha te tjera .**

- a- Import –eksport ,i materialeve te ndertimit te te gjitha llojeve dhe tregetimi i tyre me shumice e pakice .
- b- Tergetimi i artikujve te ndryshem industrial,ushqimor,i fruta perimeve artikuj bujqesor e blegetoral,bime medicinale dhe eterovajore .
- c- Tregetim automjetesh te cdo lloji ,marke,tonazhi si dhe pjese kembimi per to.
- d- Hapje pike lavazhi dhe tregetimi me pakice i karburanteve dhe vajrave lubrifikate.
- dh-Tregetim paisjesh elektroshtepijake ,elektronike ,kompjuterike ,higjenosanitare dhe hidraulike,prodhime qeramike ,artizanati etj.
- e-Hapje e shfrytzim hotelesh ,motelesh ,baresh,restaurantesh ,diskotekash ,qendra pushimi e kurative.

## **KREU II**

### **KAPITALI THEMELTAR ,KONTRIBUTET,PJESET E KAPITALIT**

#### **NENI 6**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar eshte 100.000 (njqind mije) leke.

#### **NENI 7**

#### **KONTRIBUTET**

Kontributi i percaktuar ne nenin 6 te ketij statuti i takon ortakut te vetem.

#### **NENI 8**

#### **NDARJA E FITIMIT**

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i Shoqerise i takon ortakut te vetem themelues.

#### **NENI 9**

#### **TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR**

Kuotat e kapitalit te shoqerise mund te transferohen me ane aktesh mes te gjalleve dhe me trashegimi.Transferimi i kuotave te kapitalit te shoqerise nuk i nenshtrohet asnje lloj kufizimi ,ne qoftese ndodh ne rast vdekje.

## **KREU III**

### **MARRJA E VENDIMEVE ,ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE**

#### **NENI 10**

#### **ASAMBLEJA E ORTAKEVE (ORTAKU I VETEM)**

#### **NENI 11**

#### **DREJTIMI I SHOQERISE**

Organi me i larte drejtues i shoqerise do te jete asambleja e otakeve (ortaku i vetem) Asambleja e otakeve (ortaku i vetem) mblidhet si rregull dy here ne vit,si dhe sa here qe gjykohet e arsyeshme.

#### **NENI 12**

#### **KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE (ORTAKU I VETEM)**

Asambleja e ortakeve (ortaku i vetem) vendos per keto çeshtje:

- Emeron administratorin e shoqerise.
- Emeron ekspertet kontabel

- Miraton bilancin vjetor.
- Shperndan rezerven qe ka ne dispozicion.
- Ben ndryshime ne statut.
- Vendos per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.
- Vendos per shperndarjen e shoqerise.
- Ne rast te shperndarjes se shoqerise cakton likujdatorin dhe e shkarkon ate kur perfundon likujdimi.
- Vendos per çdo problem tjetër qe i vihet ne rend te dites.
- Vendimet e asamblese (ortakut te vetem) nenshkruhen nga ortaku i vetem dhe vertetohen nga noteri.

### **NENI 13 ADMINISTRATORI**

Shoqeria do te administrohet nga Znj. MEHDI LALA.

### **NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

Per realizimin e aktivitetit te shoqerise dhe zbatimin e vendimeve te mbledhjes te asamblese se ortakeve (ortakut te vetem),administratori ka te drejten e firmes.Per probleme te veçanta administratori i autorizon per ta perfaqesuar edhe nje person te trete.Administratori ka keto kompetenca :

- Te beje drejtimin e shoqerise
- Te perpiloje dhe nenshkruaj kontratat dhe çdo akt tjetër juridik qe ka te beje me veprimtarine e shoqerise
- Te hapi llogari rrjedhese bankare prane bankave Shqiptare ,e jashte shtetit.
- Te depozitoje e te terheqi shuma parash
- Te perfaqesoje shoqerine ne mardhenie me te tretet
- Te emeruj nenpunes te rangjeve te ndryshme per veprimtari te veçanta teknike ose per nje kategori te caktuar veprimesh.
- Te bejne gjithçka tjetër qe konsideron te dobishme dhe qe eshte ne perputhje me formen e ketij Statuti e te Aktit Themelues si dhe me legjislacionin Shqiptar ne fuqi,per te arritur qellimin dhe objektin e shoqerise.

### **KREU IV LIBRAT E LLOGARISE ,BILANCI,FITIMI SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI**

### **NENI 15 LIBRAT E SHOQERISE**

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje perveç dokumentacionit kontabel qe kerkon legjislacioni ne fuqi edhe keto libra :

- 1- Libri i ortakeve,ne te cilin shenohen emrat e plote te Ortakeve dhe kuotat qe secili ka ne kapitalin e themelimit.
- 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te asamblese.
- 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te Administartorit.

**NENI 16  
VITI FINANCIAR,LLOGARITE VJETORE ,EKSPERTET KONTABEL**

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht viti i pare financiar mund te filloje pas regjistrimit te shoqerise si person juridik,por do te perfundoje me 31 Dhjetor 2005.

Llogarite vjetore ,inventaret,raportet mbi operacionet e veçanta te hartuara nga administratori miratohen nga asamblea e ortakeve.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Shoqeria do te jete e kontrolluar nga nje organ i perbere prej nje ose tre eksperteve kontabel te emeruar nga mbledhja e asamblese se ortakeve. Ata do ti permabahen kerkesave te nenit 69 te ligjit Nr.7638 ,date 19.11.1992.

## **NENI 17 ZGJATJA E AFATIT**

Zgjatja e afatit te shoqerise qe eshte percaktuar ne kete statut ,mund te vendoset nga asambleja (ORTAKU I VETEM).Ne rast se ne shoqeri pranohen ortake te tjere konform legjislacionit ne fuqi ,atehere vendimet merren me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar.

## **KREU V NENI 18 AKTIVITETI FINANCIAR**

Ne çdo mbyllje te çdo viti financiar administratori ben inventarin dhe llogarine vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin ,si dhe hartohet nje raport me shkrim.

Bilancit i bashkengjiten :

- a. Nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria.
- b. Nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria.

Raporti i administratoreve perfshi gjendjen gjate vitit financiar te kaluar ndryshimet e parashikuara,veprimtarite e mundshme qe jane zhvilluar nga data e mbylljes se vitit financiar deri ne ditën qe eshte hartuar ky raport.

## **NENI 19**

Fitime neto te shoqerise do te konsiderohen fitimet qe rezultojne pas zbritjes nga te ardhurat e te gjithë shpenzimeve qe kane lidhje me aktivitetin e shoqerise ,detyrimet fiskale,sigurimet shoqerore ,demitimet ,amortizimet,etj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veçanta financimi.

Perberja,shuma e pergjithshme ,burimet per krijimin e fondit rezerve perdorimi dhe regullimi i çdo fondi te veçante caktohet nga ortaku i vetem ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Ne perputhje me nenin 213 te ligjit "Per shoqerite Tregtare" nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar lihet menjane nje shume me vlere  $\frac{1}{20}$  e cila destinohet per krijimin e nje fondi "rezerve e domozdoshme".

## **NENI 20 PRISHJA E SHOQERISE**

Shoqeria priset me kalimin e afatit te caktuar ne statut.Per aresye qe parashikohen ne ligj.Shoqeria priset perpara afatit me vendim te Asamblese (ortaku i vetem).

## **NENI 21**

Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndyshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqerise behet ne perputhje me dispozitat e ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

## **NENI 22**

Kur shoqeria priset ajo kalon ne likujdim dhe ne kete rast emertimit te shoqerise i shtohet shenimi "Shoqeri ne likujdim e siper".Shoqeria edhe gjate procesit te likujdimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likujdimit.Prishja

e shoqerise eshte me pasoje ndaj te treteve vetem pas publikimit te prishjes ne regjistrin tregtar.

#### **NENI 23**

Per te perfunduar procesin e likujdimit ,Asambleja (ortaku i vetem) emerone nje ose disa persona si likuidues te cilet perfaqesojne shoqerine.Likuiduesi perpilon bilancin finaciar ,likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise ,shet aktivet e shoqerise dhe ndan tepricat ne dispozicion.

#### **NENI 24**

Ne perfundim te mbylljes se likujdimit ,ortaket thirren qe te vendosin per bilancin finaciar perfundimtar ,per aktin e rregullshmerise,per administrimin e tij nga ana e likujduesit dhe per heqjen e mandati te likujduesit ,si dhe per tu evidencuar mbyllja e likujdimit.

Dokumentat e mesiperme miratohen nga Asambleja (ortaku i vetem).

#### **NENI 25**

Kur shoqeria likujdohet pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi,u kthehen pronareve.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise dhe fondet fillestare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena ,pasi t'u jene bere pagesat kreditoreve.

#### **NENI 26**

#### **DISPOZITA TE FUNDIT**

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten per te ushtruar veprimtarine e saj .Punesimi behet sipas kushteve te percaktuara ne legjislacionin e punes se Republikes se Shqiperise ,si dhe rregullave te vena ne kontraten e veçante te punesimit qe lidhet midis punedhenesit e punonjesit.

Shoqeria u garanton punonjesve kushte pune dhe mjete te nevojshme per realizimin e detyres qe kryejne.

#### **NENI 27**

Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi ne Republikes e Shqiperise.

Kur mosmarreveshjet nuk zgjidhen me mirkuptim kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e shkalles se pare Tirane.

#### **NENI 28**

Ky statut firmoset me vullnet te lire te ortakut te vetem themelues.

#### **ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**MEHDI LALA**

Mehdi LALA  
.....  
05